



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 633 Prot.

Tiranë, më 08.05 2019

**VENDIM Nr. 114, datë 2.05.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, *Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit *"Rikonstruksion fasade, izolim, rikonstruksion çatie vendi" Lagjja Nr. 1, rruga "Stefan Vokopola", zona arkeologjike "A" Durrës", subjekti Z. Sami Sejko*,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zhvillimin e projektit *"Rikonstruksion fasade, izolim, rikonstruksion çatie vendi" Lagjja Nr. 1, rruga "Stefan Vokopola", zona arkeologjike "A" Durrës", subjekti Z. Sami Sejko*, me kushtin e ruajtjes së themeleve ekzistuese dhe mosçënimit të territorit.
2. Subjekti Z. Sami Sejko, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, subjekti Z. Sami Sejko duhet të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për fillimin e punimeve. Këto punime sipas fazave të zbatimit të projektit do të monitorohen nga DRKK Durrës.
4. Në rast të domosdoshmërisë së kryerjes së punimeve të infrastrukturës inxhinjerie, të paparashikuara për projektin e sipërpërmendur, subjekti Z. Sami Sejko duhet të njoftojë zyrtarisht DRKK Durrës dhe ASHA. Ai duhet të lidhë paraprakisht, akt-marrëveshje tre palëshe me DRKK Durrës, e cila do të monitorojë në mënyrë periodike ditore kryerjen e këtyre punimeve, si dhe ASHA që do të realizojë mbikëqyrjen e tyre.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO